



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYETARI

Nr. prot. 15592

Tiranë 20/4 / 2018

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZOTIT ALDRIN DALIPI

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,


Bashkëlidhur, ju dërgojmë për shqyrtim e miratim relacionin dhe projektvendimin “Për kalimin e administrimit të Parkut Rinia, si park rekreativ me gjithë elementët përbërës, nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit tek Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit”.

Me respekt,

KRYETAR

ERION VELIAJ

Erion Veliaj





**BASHKIA
TIRANË**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2018

“PËR KALIMIN E ADMINISTRIMIT TË PARKUT RINIA, SI PARK REKREATIV ME GJITHË ELEMENTËT PËRBËRËS, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR. 1 E PUNËTORËVE TË QYTETIT TEK AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat “a” dhe “b”, pika 1/1.2, shkronja “a”, nenit 23, pika 9, nenit 25, pikat 1 dhe 2, nenit 54, shkronja “e” dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Për vetëqeverisjen vendore”; neneve 11 dhe 12 të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për ronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; VKM Nr. 295, datë 20.4.2016 “Për kalimin në përdorim të Bashkisë Tiranë të pronës me nr. 619, pasuria 7/187, të ndodhur në Zonën Kadastrale 8380, për Njësinë Administrative Tiranë”; vendimit nr. 41, datë 23.09.2015 të Këshillit Bashkiak “Për riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Kalimin e administrimit të “Parkut Rinia” me gjithë elementët përbërës të tij (bimësi, stola, kosha, infrastruktura pa ndriçimin publik), pjesë e inventarit të pronave të paluajtshme të Bashkisë së Tiranës, nga Drejtoria e Përgjithshme nr.1 e Punëtorëve të Qytetit tek Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit sipas genplanit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Në përmbushje të detyrave të ngarkuara, sipas pikës 1 të këtij vendimi të miratojë një shtesë në numrin e punonjësve të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, prej 10 punëtorë dhe 3 specialistë teknik
3. Efektet financiare të këtij vendimi, konkretisht buxheti për pagesën e punëtorëve shtesë dhe shpenzimet për mirëmbajtjen e “Parkut Rinia” dhe shesheve rekreative, për vitin 2018, do të përballohen nga buxheti i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme nr.1 e Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit për ndjekjen e procedurave të kalimit të Aseteve, inventarit fizik në zbatim të këtij vendimi.

5. Në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, kryetari i bashkisë nxjerr urdhrin përkatës për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e procedurave për kalimin e aseteve dhe kryerjen e inventarit fizik.

6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

K R Y E T A R I

Aldrin Dalipi

RELACION

“PËR KALIMIN E ADMINISTRIMIT TË PARKUT RINIA, SI PARK REKREATIV ME GJITHË ELEMENTËT PËRBËRËS, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR. 1 E PUNËTORËVE TË QYTETIT TEK AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat “a” dhe “b”, pika 1/1.2, shkronja “a”, nenit 23, pika 9, nenit 25, pikat 1 dhe 2, dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”; neneve 11 dhe 12 të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); VKM Nr. 295, datë 20.4.2016 “Për kalimin në përdorim të Bashkisë Tiranë të pronës me nr. 619, pasuria 7/187, të ndodhur në Zonën Kadastrale 8380, për Njësinë Administrative Tiranë”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 23.09.2015 për “Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”, i ndryshuar me VKB nr.88, datë 26.07.2017; dhe me propozim të të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, i paraqesim Këshillit Bashkiak materialin sa më poshtë:

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit (APR) është krijuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 41, datë 23.09.2015 për “Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”, si institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës. Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, që nga krijimi i saj, synon rritjen e kujdesit për parqet ekzistuese, memorialet tematike, historike, krijimin e parqeve të reja, dhe rritjen e kujdesit për parqet dhe hapësirat e aktiviteteve rekreative në dobi të komunitetit e cilësinë e jetesës në territorin e Bashkisë së Tiranës përmes gjelbërimit, parqeve dhe aktiviteteve rekreative në natyrë, si dhe një zhvillim të qëndrueshëm përmes edukimit qytetar për ruajtjen e mjedisit dhe hapësirave publike.

Objektivat që synohen të arrihen kërkojnë saktësimin e kompetencave dhe rregullimin e administrimit sa më efektiv të këtyre hapësirave publike, uljen e kostove përmes shfrytëzimit të logjistikës në mënyrë të përqendruar, kombinimin e funksionalitetit të infrastrukturës rekreative me aktivitetet komunitare të jetesës aktive, kujdesin për kushtet e sigurisë, standartizimin, projektimin bashkëkohor dhe përcaktimin e rregullave të qarta për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe menaxhimin publik sa më eficient të këtyre hapësirave në dobi të komunitetit. ATELIER i APR garanton projektimin, ndjekjen e ndërhyrjeve rikualifikuese e mobilimit rekreativ.

APR ka hartuar një strategji zhvillimi bazuar në nevojat e komunitetit, për mirëmbajtjen e hapësirave ekzistuese e ndërtimin e hapësirave të reja rekreative, nëpërmjet krijimit dhe vënies në zbatim të projekteve të ndryshme si nga ana e infrastrukturës, mirëmbajtjes si dhe organizimin e aktiviteteve të larmishme rekreative. Gjithashtu Parku Rinia do ketë zonën e vet të këndit të lodrave publike.

“Parku Rinia” është parku publik qendror i kryeqytetit, konceptuar në 1931 dhe ndërtuar në vitin 1949, që mbulon një sipërfaqe prej 29.81 ha. Për qendrën e Tiranës u hartuan disa variante projektesh, të cilat pavarësisht nga ndryshimet që pësuan deri në realizim, kishin në bosht aksin e bulevardit ku kryqëzoheshin të gjitha rrugët e qytetit, vend që asokohe ishte hapësirë e zbrazët. Projekti i parë nis që në 1923, por varianti më i suksesshëm, në përshtatje me ambiciet e Mbretit Zog për ta bërë Tiranën një qytet modern europian, daton në 1931 dhe mban firmën e arkitektëve italianë Brasini dhe De Fausto. Sipas këtij plani, u ndërtua kompleksi i ministrive, Bashkia e Tiranës, Banka Kombëtare,

lulishtja e këtij kompleksi qëndror, sheshi qendror me shatërvanin si dhe ajo që sot njihet si “Parku Rinia”.

Parku Rinia ndodhet 500 m nga sheshi qendror Skënderbej, kufizohet në lindje nga Bulevardi Dëshmorët e Kombit, në jug Bulevardi Gjergj Fishta dhe Bulevardi Bajram Curri, në perëndim Rruga Ibrahim Rugova (ish rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit") blloku i pallateve Shallvare dhe në veri Rruga Myslym Shyri, shumë shpejt pjesë e një kolone kurrizore kryesisht për këmbësorë e rekreacion aktiv. Programet komunitare, sociale dhe interaktive mes natyrës dhe njerëzve janë mision kryesor për detyrat funksionale të APR, për Platformën e App-in Tirana Ime Outdoor. Grupet e kujdesit nga APR funksionojnë në paketë, para e pas aktiviteteve, sektorë të ndryshëm brenda APR menaxhojnë partnerët dhe programet speciale.

“Parku Rinia” është sot një nga hapësirat që ofron shumë mundësi rekreative për qytetarët e të gjitha moshave dhe përbën një pikë atraktive për qytetin e Tiranës dhe si rrjedhojë një zonë të frekuentuar nga një numër i madh qytetarësh, dhe në ngjashmëri me shumë eksperiencë ndërkombëtare hyn në kategori park e jo lulishte.

Pasuria parku “Rinia” me nr. 7/322, Zona Kadastrale 8380, me sipërfaqe 24 910 m² nëpërmjet VKM Nr. 295, datë 20.4.2016 “Për kalimin në përdorim të Bashkisë Tiranë të pronës me nr. 619, pasuria 7/187, të ndodhur në Zonën Kadastrale 8380, për Njësinë Administrative Tiranë”, ka kaluar në përdorim të Bashkisë së Tiranës. Me aplikimin nr. 00015361, datë 31.05.2016 është realizuar shënimi në kartelë, “Kalon në përdorim të Bashkisë së Tiranës”

Objektivat e synuara kërkojnë kalimin e Parkut Rinia nën administrimin e APR-së duke përcaktuar rregulla të qarta për mirëmbajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e kësaj hapësire në funksion të rritjes së cilësisë së jetës së qytetarëve si dhe shërbimeve publike të ofruara me fokus të veçantë tek fëmijët, të moshuarit dhe frekuentuesve të shumtë të këtij Parku. APR që prej krijimit të saj organizon aktivitete të ndryshme kulturore, artistike, edukuese në këtë hapësirë dhe administrimi i këtij parku do të zgjerojë gamën e këtyre aktiviteteve si dhe do të sjellë një përgjegjshmëri e përkushtim më të lartë ndaj tij falë edhe pozicionimit të volitshëm. Puna e nisur në kuadrin e projektit të Parkut të Besimit, në një aks nga PMLAT deri te Sheshi Skënderbej, që profilizon si parqe të një rëndësie të spikatur këto hapësira dhe i vesh një mision të dyfishtë rekreativ prej aktiviteteve e zonave pedonale në afërsi të tyre e bën më të specializuar nevojën për kujdes, projektim, zhvillim e kurim peisazhi të gjelbër dhe mirëmbajtje që merr parasysh eventet në to.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë qëllimin dhe misionin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit si dhe sa kemi shpjeguar në këtë relacion, ju parashtrojmë për miratim kalimin e Parkut Rinia, si dhe Shesheve Rekreative (ato lulishte me kënde lodrash dhe sportive) me gjithë elementët përbërës të tyre (bimësi, stola, kosha, infrastruktura pa ndriçimin publik) nga Drejtoria e Përgjithshme nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit në administrim të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit.

Z. Blendi Gonxhja

Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

Znj. Arlinda Binjaku

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme nr.1 e Punëtorëve të Qytetit

Znj. Drilona Aliko
Specialist, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Z. Raif Halidini
Specialist, Sektori i Regjistrimit dhe Inventarizimit

Znj. Anisa Seferaj
Përgjegjës, Sektori i Regjistrimit dhe Inventarizimit

Znj. Enola Bejko
Përgjegjës, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Znj. Laura Deliu
Drejtor, Drejtoria Juridike

Z. Alban Dokushi
Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit

Znj. Jonida Halili
Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Znj. Keti Luarasi
Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore

Z. Arbjan Mazniku
Zv. Kryetar

Znj. Esmeralda Demiraj
Jurist, Këshilli Bashkiak

Z. Behar Zeneli
Sekretar, Këshilli Bashkiak